

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI JURIDIK**  
**STUDIMET MASTER**  
**DREJTIMI PENAL**



---

**Fakulteti Juridik**  
Faculty of Law

**PUNIM DIPLOME**

**Tema:**

**Vështrim Krahasues i Arrestit Shtëpiak Midis Kosovës, Shqipërisë Dhe  
Austriës**

**Mentori:** Prof Dr. Azem Hajdari

**Kandidati:** Dren Berisha

Prishtinë 2024

## Abstrakt

Arresti shtëpiak është një masë e ndërmarrë nga sistemet e drejtësisë penale për të kufizuar lirinë e individëve në vendbanimin e tyre, duke i ndaluar ata të dalin nga vendbanimi, me përjashtim të disa aktiviteteve të caktuara si puna, vizitat mjekësore dhe pjesëmarrja në programe rehabilituese. Përgjegjësia për zbatimin e kësaj mase i jepet zyrtarëve policor, përkatësisht stacionit policor përkatës në territorin në të cilin duhet të zbatohet masa, të cilët janë të detyruar të monitorojnë të arrestuarit në shtëpi. Ata kryejnë kontrole të rregullta, të rastësishme përmes telefonatave dhe personalisht. Në rast se urdhrat gjyqësore shkelën, ka pasoja të rënda përfshirë referimin në gjykatë dhe në shumicën e rasteve burgim. Përfitimet kryesore të arrestit shtëpiak përfshijnë kursimin e kostove në krahasim me burgimin, mbështetjen e familjes së shkelësit dhe ruajtjen e punësimit dhe detyrimeve familjare. Megjithatë, një nga disavantazhet kryesore është niveli më i ulët i mbrojtjes publike në krahasim me paraburgimin. Prandaj, rekomandohet që arresti shtëpiak të kufizohet te rastet që nuk paraqesin një rrezik serioz për publikun, duke përfshirë shkelësit jo të dhunshëm dhe ata të akuzuar për vepra më të lehta penale.

Arresti shtëpiak është një kufizim i lirisë së lëvizjes në të cilin shkelësit urdhërohen nga gjykata të qëndrojnë të mbyllur në vendbanimin e tyre, me përjashtim që të lejohen të largohen vetëm për arsye mjekësore dhe punësimi. Kjo masë ka avantazhe si efektshmëria dhe kostot e ulëta, por disavantazhe si mungesa e ashpërsisë së ndëshkimit dhe fokusi më shumë në mbikëqyrje sesa në rehabilitim. Për të shmangur këto probleme, është e rëndësishme që arresti shtëpiak të përdoret me kujdes dhe të përfshijë kritere të qarta dhe të drejtpërdrejta në përzgjedhjen e pjesëmarrësve.

Ky punim shqyrton natyrën dhe arsyet e arrestit shtëpiak, duke krahasuar avantazhet dhe disavantazhet e tij, si dhe duke bërë një analizë të ngjashmërive dhe ndryshimeve ndërmjet praktikave të kësaj mase në Kosovë, Shqipëri dhe Austri. Përfundimisht “arresti shtëpiak” mund të shihet si një alternativë efektive ndaj burgimit për disa shkelës, duke sjellë një balancë midis zbatueshmërisë dhe respektimit të të drejtave të individit.

Fjalët kyçe: Arresti Shtëpiak, Masa gjyqësore, procedura penale etj.